




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVA	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. <u>2-D/DPK</u>	Nr. Prot. <u>01-2091/2012</u>
Nr. i faq. <u>02</u>	Data <u>13-06-2012</u>
Nr. pages <u>02</u>	Datum <u>13-06-2012</u>



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 29.05.2012, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr.AKK– 03-4080/11,për Zyrtarin e Lartë, z.Ferit Idrizi, Kryesues i Kuvendit Komunal ne Vushtrri, për shkak se Zyrtari i Lartë ka shmangur gjendjen e mundshme te konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të mundshëm te interesit është zhvilluar procedura e parapare sipas nenit 18.2 te ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit te Interesit ne Ushtrimin e Funksionit Publik,

Pas informatës se marre nga një imell me adresë anonime ka filluar shqyrtimi i lendes me numër protokolli AKK–03-4080/11, që për trajtim ka pasur Zyrtarin e Lartë, z.Ferit Idrizi, Kryesues i Kuvendit Komunal ne Vushtrri.

Gjate zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se zyrtari e lartë, gjatë kohës se ushtrimit të funksionit publik si, Kryesues i Kuvendit Komunal ne Vushtrri është duke ushtruar edhe funksionin e Zyrtarit te Lartë si, Drejtor i Departamentit për Bashkëpunim Ndërkombëtare, Koordinim dhe Zhvillim te Integritimeve Evropiane ne Ministrin e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, e që sipas Ligjit për parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L-051, kjo situatë ka paraqitur konflikt të mundshëm të interesit, dhe mos pajtueshmëri ne ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 13.03.2012, e ka njoftuar zyrtarin e Lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejte në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet qe posedon Agjencia.

Pas këtyre procedurave, z.Ferit Idrizi, Kryesues i Kuvendit Komunal ne Vushtrri, pasi ka kontaktuar me zyrtaret e Agjencisë ka ardhur te ballafaqohet me faktet qe posedon Agjencia, gjate takimit qe është mbajtur ne zyrat e AKK-se është biseduar për gjendjen dhe faktet qe disponon Agjencia lidhur me konfliktin e mundshëm të interesit.

Zyrtari i Lartë, z.Ferit Idrizi,, gjatë takimit është pajtuar për situatën, mirë po është arsyetuar se nuk ka qenë informuar për këtë, pasi qe nuk e ka informuar as kush qe nga momenti i zgjedhjes si, Drejtor i Departamentit për Bashkëpunim Ndërkombëtar, Koordinim dhe Zhvillim te Integritimeve Evropiane ne Ministrin e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe nuk ka pas njohuri për këtë situatë qe mundë te shkaktoj konflikt te mundshëm të interesit dhe mos pajtueshmëri ne ushtrimin e funksionit publik.

z.Ferit Idrizi, Kryesues i Kuvendit Komunal ne Vushtrri ,është zotuar se ne afatin ligjor do te jap dorëheqje nga pozita e Kryesuesit te Kuvendit Komunal ne Vushtrri dhe do ta bej shmangien Konfliktit te mundshëm të Interesit.

Me datën 20.03.2012, Zyrtari i Lartë, z. Ferit Idrizi, Kryesues i Kuvendit Komunal ne Vushtrri, ka sjellë dëshminë se i ka ber kërkesën Kuvendit Komunal ne Vushtrri se ka vendosur te tërhiqet nga pozita e Kryesuesit te Kuvendit Komunal ne Vushtrri, pasi qe është ne marrëdhënies pune në Ministrin e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe e ka te pa mundur qe njëkohësisht te kryej edhe funksionin e Kryesuesit te Kuvendit Komunal ne Vushtrri.

Agjencia kundër Korrupsionit ka përciellurë ecurinë deri sa është njoftuar nga Kuvendi Komunal ne Vushtrri se z.Ferit Idrizi ka dhen dorëheqje, kurse kryesues është zgjedhur z.Habib Mustafa.

Andaj konsiderojmë se z Ferit Idrizi, ka shmangur gjendjen e mundshme te Konfliktit te Interesit ne te cilën ndodhej.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

